



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	19. 01 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKRIMSHOK	214/2021		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.388/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca, anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.388/2020 të datës 04.12.2020 të parashtruar përmes adresës elektronike nga ankuesi me adresë rruga “Aleksandër Moisiu”, Nr.10 Lagjja NIC, në Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe organit të punësimit Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 18.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë ankesa me numër A.nr.388/2020 e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2934/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për heshtje administrative të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me mos njoftimin për mos vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitë të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Me datë 22.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.12.2020 me Nr.Prot:2934/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigje nr.260/2 e datës 23.01.2020 në kërkesë për opinion ligjor; Kërkesë për interpretim ligjor të datës 20.08.2020 për MAP; E-mail i datë 29.09.2020; Përgjigje nr.874/2 e datës 25.09.2020 në kërkesë të datës 14.09.2020 nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Njoftim nr.881/2 i datës 05.10.2020 nga Ministria e Punëve të Brendshme; Njoftim nr.2843 i datës 16.07.2020; Njoftimi nr.693 i datës 28.08.2020; E-mail i datës 12.03.2020; Përgjigje nr. protokolli 3261/2020 në ankesë e datës 22.12.2020; Kërkesë Nr.2570 i datës 02.07.2020 për kthim në vendin e punës; Kërkesë e përsëritur Nr.2874 i datës 20.07.2020 për kthim në vendin e punës; Autorizim i datë 20.07.2020; Vendimi nr.2824 i datës 22.07.2017; Vendimi Nr.867 i datës 19.02.2020 për pezullim parandalues; Njoftim nr.06/2 i datës 12.02.2020 nga Prokuroria Shtetit; Prova shtesë e datës 11.01.2021, Vendimi nr.07/23 i datës 13.07.2011; Vendimin me Nr.refKM.50/20 i datës 27.02.2020; Vendimin me Nr.refKM.116/20 i datës 01.07.2020; Vendimin me Nr.refKM.50/20 i datës 27.02.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pa lejuar sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.07/23 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 13.07.2011 është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me mandat tre (3) vjeçar, ankuesit me Vendimet Nr.10/194 të datës 23.07.2014 dhe Vendimi i fundit Nr.12/149 të datës 17.07.2017, i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite tjera, deri më datë 17.07.2020, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se është diskriminuese mos dhënia e mundësisë për ri-zgjatje të mandatit sipas nenit 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kolegji pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se me nenin 83 paragrafi 6 të këtij ligji, nëpunësve civil të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore të cilët janë emëruar sipas procedurës së Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publik, ju garantohet e drejta e ushtrimit të mandatit për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka marr parasysh se ankuesi në ankesën e tij deklaron se deri me datë 19.02.2020 e ka ushtruar mandatin e plotë, në pozitën e Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sepse me Vendimin me Nr. 867 të datës 19.02.2020, të Ministrisë të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka qenë në pezullim parandalues me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, Kolegji konstaton se ankuesi sipas vendimin Nr.12/149 të datës 17.07.2017 ka pas mandat të Sekretarit të Përgjithshëm në MBPZHR deri më datë 17.07.2020, ankuesi pretendon se në mënyrë të kundërligjshme nuk i është dhënë mundësia për vazhdim të mandatit.

Prandaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e



Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimin Nr.12/149 të datës 17.07.2017 për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm në MBPZHR, si dhe momentin e skadimit të mandatit të ankuesit nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR datë 17.07.2020, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 04.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.388/2020**

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Arkivit të KPMSHCK-së.